

UDHËZIM
Nr.10, datë 13.5.2005

**PËR MBLEDHJEN, ADMINISTRIMIN DHE PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT PËR
PROCESIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar

Në mbështetje të nenit 153 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 29 pika 1, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat që do të zbatojnë KZZ-ja dhe KQZ-ja për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit, për procesin e numërimit të votave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 2005.

Neni 2

Informacioni që do të japë KZZ-ja

Pas mbylljes së votimit, KZZ-ja duhet të dërgojë në KQZ informacionin për:

- a) ecurinë e dorëzimit të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive me materialet e votimit;
- b) fillimin e numërimit të votave;
- c) rezultatet e zgjedhjeve të çdo QV-je për kandidatët për deputetë dhe për partitë politike dhe/ose koalicionet, në mënyrën e përcaktuar në këtë udhëzim.

Neni 3

Përmbajtja e informacionit për rezultatet e zgjedhjeve

- 1. Informacioni për procesin e numërimit të votave mbështetet në tabelat e rezultateve të plotësuar nga grupet e numërimit dhe të dorëzuara në KZZ.
- 2. Ai duhet të përmbajë domosdoshmërisht për çdo QV:
 - a) numrin e fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit përkatësisht për kandidatët dhe për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore;
 - b) shpërndarjen e votave të vlefshme për kandidatët dhe për partitë politike dhe/ose koalicionet zgjedhore.

Neni 4

Koha dhe mënyra e dhënies së informacionit për rezultatet nga KZZ-ja në KQZ

1. KZZ i përcjell KQZ-së informacionin e përcaktuar në pikën 2.a dhe pikën 2.b të nenit 3 të këtij udhëzimi për çdo 5 tabela rezultatesh të të njëjtit lloj të dorëzuara nga GN-të, deri në përfundimin e procesit të numërimit e vlerësimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GN-ve.

2. Pas miratimit me vendim nga KZZ-ja të tabelës përmbledhëse të rezultateve të Zgjedhjeve për zonën zgjedhore përkatëse, KZZ-ja përcjell në KQZ të dhënat e kësaj table sipas pikës 2.a dhe pikës 2.b të nenit 3 të këtij udhëzimi, në rang zone zgjedhore.

Neni 5

Përcjellja e informacionit në KQZ

Përcjellja e informacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, në KQZ, bëhet nën drejtimin dhe përgjegjësinë e sekretarit të KZZ-së.

Neni 6

Publikimi i informacionit lidhur me procesin e numërimit të votave

Me marrjen e informacionit nga KZZ-të, KQZ, pas sistemimit të tij, bën publikimin në dinamikë në rang zone zgjedhore. Për rezultatin e zgjedhjeve për partitë politike dhe/ose koalicionet, publikimi bëhet edhe në rang vendi.

Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në sallën e mediave, elektronikisht e në letër, dhe në faqen e KQZ-së në internet.

Neni 7

Informacioni i publikuar nga KQZ-ja, në çdo rast, shoqërohet me numrin gjithsej të QV-ve në zonën përkatëse zgjedhore dhe me numrin e QV-ve mbi të cilin është llogaritur rezultati i dhënë.

Neni 8

Informacioni i publikuar sipas këtij udhëzimi nuk përbën rezultat zyrtar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.